

NJOFTIM

Kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe roli i Entit Rregullator të Energjisë në mbrojtjen e konsumatorëve

Përfaqësuese të Entit Rregullator të Energjisë, ERE, morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga



Akademia e Konsumatorit si lektore dhe advokate të promovimit të informacionit me qëllim mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike. Anëtarja e Bordit të ERE znj. Erjola Sadushi, dhe Drejtorja e Mbrojtjes së Konsumatorit në ERE znj. Julia Guga prezantuan për pjesëmarrësit, një pasqyrë të kuadrit rregullues të sektorit të energjisë elektrike që lidhej kryesisht me të drejtat e

konsumatorit. Me qëllim arritjen e informacionit sa më pranë konsumatorit, përfaqësueset e ERE

prezantuan mes të tjerave si pjesë të fushatës informative, broshurat informative, si dhe mundësitë e aksesit në informacion të konsumatorëve, nëpërmjet faqes zyrtare të ERE, www.ere.gov.al, si dhe rrjeteve sociale të saj.

